



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA KORÇË

DREJTORIA E PËRGJITHSHME JURIDIKE DHE E MENAXHIMIT TË BURIMEVE NJERËZORE

Nr. 11272 / prot.
17

Korçë, më 10.12.2024

NJOFTIM

“Për përfundimin e procedurës”

Bazuar në nenin 23 pika 6 dhe 54 gërma k të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, në nenin 14 të ligjit Nr. 8308 datë 18.03.1998 “Për transportet rrugore” të ndryshuar, VKM Nr. 325 dt 19.03.2008 “Për miratimin e rregullave për pranimin në veprimtarinë e operatorit të transportit rrugor të mallrave dhe të udhëtarëve si dhe për njohjen e dokumentave zyrtarë të caktuara për këta operatorë” i ndryshuar, Udhëzimi Nr. 5627 datë 18.11.2016 të Ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës “Për përcaktimin e kriterëve, rregullave dhe dokumentacionit për lëshimin e licencave dhe çertifikatave për ushtrimin e veprimtarisë në transportin rrugor “ të ndryshuar, VKB Nr. 149 dt. 21.10.2024 “Mbi përcaktimin e kriterëve për përzgjedhjen nëpërmjet konkurrimit të subjektit që do të kryejë transportin qytetës (urban), me subvencion” dhe VKB Për miratimin e buxhetit vjetor 2024 dhe PBA 2024-2026 të Bashkisë Korçë”, Bashkia Korçë ka filluar procedurën e konkursit për përzgjedhjen e subjektit që do të kryejë me subvencionim shërbimin e transportit qytetës në të katër linjat e Bashkisë Korçë. Mbështetur në urdherin e Kryetarit të Bashkisë Korçë Nr. 1229 dt. 25.11.2024, Bashkia Korçë në dt. 27.11.2024 shpalli konkursin për përzgjedhjen e subjektit që do të kryejë me subvencionim shërbimin e transportit qytetas në katër linjat e Bashkisë Korçë.

Në dt. 12.12.2024 tek salla e mbledhjes Kati 2, në Bashkinë Korçë, u mbledh komisioni ngritur mbi bazën e urdherit Nr. 1229 dt. 25.11.2024 të Kryetarit të Bashkisë Korçë.

Nga komisioni u konstatua se në bazë të njoftimit 11272/1 Prot dt. 26.11.2024 publikuar në dt. 27.11.2024 “Për zhvillimin e konkursit nëpërmjet të cilit do të kryhet përzgjedhja e subjektit që do të kryejë shërbimin e transportit qytetës (urban) me subvencion, rezulton se asnjë subjekt nuk ka shprehur interes për pjesmarrje në këtë procedurë. Në Zyrën e Arkivës në Bashkinë Korçë, nuk është dorëzuar asnjë shprehje interesi apo dokumentacion për këtë procedurë.

Në këto kushte Kryetari të Bashkisë me vendim shpalli përfundimin e procedurës së konkursit për përzgjedhjen e subjektit që do të kryejë shërbimin e transportit qytetës, pa fitues.

KRYETARI
SOTIRAO FILO

